

# UDHËZUES PËR KËRKESAT MINIMALE TË SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PËRDORIMIN E PAJISJEVE TË PUNËS NË VENDIN E PUNËS

Ky Udhëzues përcakton masat që duhet të ndërmarrin punëdhënësit dhe punëmarrësit, për të garantuar përdorimin e sigurtë të pajisjeve të punës në vendin e punës. Ky Udhëzues përdoret për të gjithë sektorët në Kosovë.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija,  
Rada i Trasfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers*

# PËRMBAJTJA

HYRJE.....	3
FUSHËVEPRIMI DHE QËLLIMI.....	3
DETYRIMET E PËRGJITHSHME TË PUNËDHËNËSIT LIDHUR ME KËRKESAT MINIMALE TË SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PËRDORIMIN E PAJISJEVE TË PUNËS NË VENDIN E PUNËS.....	4
LEGJISLACIONI LIDHUR ME KËRKESAT MINIMALE TË SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PËRDORIMIN E PAJISJEVE TË PUNËS NË VENDIN E PUNËS.....	10
AUDITIMET.....	11
VËREJTJET PËRFUNDIMTARE.....	11
SHTOJCA 1: SHEMAJ TË FAKTORËVE TË RREZIKUT PËR PARANDALIMIN E LËNDIMEVE NGA MJETET E MPREHTA NË VENDET E PUNËS NË SEKTORIN E KUJDESIT SHËNDETËSOR DHE SPITALOR.....	11



## HYRJE

Siguria dhe shëndeti i punonjësve në vendin e punës, duhet të jenë ndër prioritetet kryesore të çdo punëdhënësi. Përdorimi i pajisjeve të punës përbën një nga faktorët më të rëndësishëm në këtë drejtim, duke paraqitur potencialisht rreziqe të konsiderueshme nëse nuk menaxhohet në mënyrën e duhur.

Ky Udhëzues është hartuar në përputhje me kërkesat e **Rregullores (MPMS) Nr. 05/2014 për Kërkesat Minimale të Sigurisë dhe Shëndetit në Përdorimin e Pajisjeve të Punës në Vendin e Punës dhe Rregullores (MPMS) Nr. 02/2020 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 05/2014 për Kërkesat Minimale të Sigurisë dhe Shëndetit në Përdorimin e Pajisjeve të Punës në Vendin e Punës**, si dhe ka për qëllim të ofrojë udhëzime të qarta dhe praktike për zbatimin e standardeve të sigurisë.

Nëpërmjet këtij Udhëzuesi:

- Punëdhënësit udhëzohen për detyrimet që duhet të përmbushin, për të siguruar pajisje pune të sigurta dhe të mirëmbajtura;
- Punonjësit informohen për mënyrën e përdorimit të sigurt të pajisjeve dhe rolin e tyre në mbrojtjen e shëndetit personal dhe të kolegëve të tyre;
- Ofrohen procedura për inspektim, mirëmbajtje dhe trajnim të punonjësve për t'u siguruar që çdo pajisje përdoret në përputhje me kërkesat ligjore dhe teknike.

Zbatimi i masave të përshkruara në këtë udhëzues kontribuon në krijimin e një mjedisi pune më të sigurt, uljen e aksidenteve dhe përmirësimin e performancës organizative në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurisë në punë.

**Ky Udhëzues duhet të përdoret si një dokument praktik, referues dhe trajnues për të gjithë ata që janë të përfshirë në përdorimin dhe menaxhimin e pajisjeve të punës.**

## FUSHËVEPRIMI DHE QËLLIMI

Ky Udhëzues ka për qëllim të ofrojë një përmbledhje praktike, të qartë dhe të lehtësuar mbi kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në përdorimin e pajisjeve të punës në vendin e punës, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi. Udhëzuesi është i zbatueshëm për të gjitha pajisjet e punës të përdorura në çdo lloj veprimtarie pune, pavarësisht nga sektori i punës. Ai synon të shërbejë si një mjet ndihmës për:

- **Punëdhënësit**, në përmbushjen e detyrimeve të tyre ligjore për sigurinë dhe shëndetin në punë;
- **Punëmarrësit**, në kuptimin dhe zbatimin e masave mbrojtëse gjatë përdorimit të pajisjeve të punës;
- **Profesionistët e sigurisë dhe shëndetit në punë**, në procesin e vlerësimit të riskut dhe ofrimit të këshillave teknike për pajisjet.



### Objektivat kryesore të Udhëzuesit janë:

- **Rritja e ndërgjegjësimit** të punëdhënësve dhe punëmarrësve, për rëndësinë e përdorimit të sigurt të pajisjeve të punës;
- **Mbështetja në zbatimin e masave parandaluese**, për të reduktuar apo eliminuar rreziqet që mund të paraqesin pajisjet gjatë përdorimit të tyre;
- **Promovimi i një mjedisi pune të sigurt dhe të shëndetshëm**, përmes aplikimit të praktikave të mira të sigurisë dhe udhëzimeve teknike që ndihmojnë në menaxhimin e rreziqeve;
- **Lehtësimi i interpretimit të kërkesave ligjore**, duke i bërë ato më të kuptueshme dhe të zbatueshme në praktikë për të gjithë akterët e përfshirë në procesin e punës.

## DETYRIMET E PËRGJITHSHME TË PUNËDHËNËSIT LIDHUR ME KËRKESAT MINIMALE TË SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PËRDORIMIN E PAJISJEVE TË PUNËS NË VENDIN E PUNËS

Punëdhënësi është i detyruar të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që pajisjet e punës, të cilat vihen në dispozicion të punëmarrësve në vendin e punës, të jenë të përshtatshme për kryerjen e detyrave të tyre dhe të mos përbëjnë rrezik për sigurinë dhe shëndetin e tyre. Gjatë përzgjedhjes së pajisjeve të punës që pritet të përdoren, punëdhënësi duhet të ketë parasysh veçoritë e vendit të punës, natyrën e detyrave dhe rreziqet potenciale që mund të ndikojnë në sigurinë dhe mirëqenien e punonjësve. Duhet të merret në konsideratë çdo rrezik shtesë që mund të lindë nga vetë përdorimi i pajisjeve. Nëse nuk është e mundur të sigurohet eliminimi i plotë i rreziqeve që lidhen me pajisjet e punës, punëdhënësi duhet të ndër marrë masa mbrojtëse për të zvogëluar këto rreziqe në nivelin më të ulët të mundshëm.

Punëdhënësi ka për detyrë të bëjë:

1. Sigurimin e pajisjeve të përshtatshme për punë;
2. Vlerësimin dhe minimizimin e rreziqeve të mundshme nga përdorimi i pajisjeve;
3. Sigurimin e mirëmbajtjes dhe inspektimeve të rregullta;
4. Trajnimin dhe informimin e punëmarrësve për përdorimin e sigurt;
5. Pajisjen e punëmarrësve me mjete personale mbrojtëse;
6. Mbajtjen e dokumentacionit për mirëmbajtje, trajnime dhe kontroll.

### RREGULLAT LIDHUR ME PAJISJET E PUNËS

Për të siguruar që pajisjet e punës të përdoren në mënyrë të sigurt dhe korrekte, në mënyrë që të mos rrezikohet shëndeti dhe jeta e punëtorëve, punëdhënësi duhet të ndër marrë masa të përshtatshme për një përdorim të rregullt dhe të kontrolluar të tyre. Pajisjet duhet të përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë projektuar dhe në përputhje me udhëzimet teknike të prodhuesit. Po ashtu, duhet të merren masa për të shmangur rreziqet që mund të shkaktohen nga funksionimi, aktivizimi apo lëvizja e pakontrolluar e këtyre pajisjeve.



**Kufizim të kontrolluar për përdorimin e mjeteve** - Mjetet e punës duhet të përdoren vetëm nga personat e autorizuar dhe të trajnuar për përdorimin e këtyre pajisjeve të punës dhe pajisjet e ndërlikuara apo potencialisht të rrezikshme, nuk duhet të përdoren nga personat e pa trajnuar.

**Masat për rastet e ndërprerjes së energjisë ose defekteve** - Në rast avarie, pajisja duhet të ndalet menjëherë dhe të mos riaktivizohet pa u verifikuar siguria e saj.

Duhet të ketë sisteme të duhura për izolimin nga burimet e energjisë gjatë mirëmbajtjes ose ndërhyrjeve teknike.

**Mbrojtja ndaj rreziqeve mekanike, elektrike, termike apo të tjera** - Duhet të ndërmerren masa për mbrojtje nga pjesët e lëvizshme të pajisjeve, mbinxehja, kontakti me energji elektrike, ose materiale të rrezikshme që pajisja mund të përpunojë.

**Pajisja me elemente mbrojtëse dhe masa parandaluese** - Pajisjet duhet të jenë të pajisura me: Mekanizma mbyllës sigurie, ndërprerës emergjent, paralajmërime dhe sinjalizime vizuale ose zanore, pjesë të mbrojtura nga aksesit i drejtpërdrejtë në komponentët e rrezikshëm.

**Përputhshmëria me normat dhe standardet e sigurisë** - Pajisjet duhet të jenë të certifikuara sipas standardeve në fuqi, dhe të jenë në përputhje me legjislacionin vendor dhe atë evropian për sigurinë teknike.

#### **Shembull praktik për zbatim:**


Në një punishte metali, një makinë prerëse elektrike duhet të ketë:

Ndërprerës të menjëhershëm në rast avarie;

Mbrojtëse plastike mbi tehun prerës për të parandaluar kontaktin aksidental;

Paralajmërim vizual me dritë të kuqe gjatë funksionimit;

Udhëzime të qarta të vendosura mbi pajisje dhe të përdoret vetëm nga punonjës të trajnuar.



## **KONTROLLI I PAJISJEVE TË PUNËS**

Punëdhënësi duhet të sigurojë që të gjitha pajisjet e punës, gjatë gjithë ciklit të tyre të jetës në vendin e punës, të kontrollohen në mënyrë të rregullt dhe profesionale për të garantuar sigurinë teknike, funksionalitetin dhe përputhjen me kërkesat ligjore të sigurisë dhe shëndetit në punë. Siguria e pajisjeve të punës varet nga kushtet e instalimit, për këtë arsye, punëdhënësi, nëpërmjet personave kompetentë, duhet të sigurojë kryerjen e kontrollit fillestar pas instalimit dhe përpara vënies në punë për herë të parë të pajisjeve. Po ashtu, pajisjet duhet të kontrollohen edhe pas çdo instalimi në një vend pune të ri apo pas ndryshimit të vendndodhjes së tyre.

Nëse pajisja e punës i ekspozohet kushteve të cilat mund të shkaktojnë përkeqësim të gjendjes së saj dhe mund të sjellë situata të rrezikshme të cilat mund të korigjohen me kohë, punëdhënësi garanton:

Kontrolla periodike, duhet të bëhet testimi, testime periodike nga persona kompetentë për të garantuar funksionimin e sigurt të saj.

Në rrethana të jashtëzakonshme duhet kryhen kontrolla speciale nga persona kompetentë, situata këto që janë shkaktare për rrezikimin e sigurisë së pajisjeve të punës të tilla si: rikonstrukcione apo ndryshime

të tjera në procesin e prodhimit, ndryshimet, aksidentet, dukuritë natyrore apo periudha të zgjatura të mospërdorimit.

Sipas legjislacionit në fuqi këto kontrole kryhen nga personat e kualifikuar, profesionistë që kanë kualifikimin e nevojshëm e që mund të jenë edhe nga ndonjë organizatë e jashtme përkatëse që lidhet me këtë fushë. Rezultatet e këtyre inspektimeve duhet të regjistrohen dhe ruhen, në mënyrë që të jenë në dispozicion të autoriteteve kompetente. Gjithashtu, nëse pajisja e punës përdoret jashtë ndërmarrjes, asaj duhet t'i bashkangjitet një kopje me shkrim e rezultateve apo me dokumente të tjera që kanë lidhje me kontrollin e fundit.

### Shembull praktik për zbatimin e një pajisjeje, psh. Kompresor industrial i ajrit:

- Kontroll fillestar: Para përdorimit të parë, kompania fton një teknik të licencuar për të verifikuar instalimin dhe presionin e punës;
- Kontroll periodik: Kryhet çdo 6 muaj nga inxhinieri i siguar nga një kompani e certifikuar për inspektim teknik;
- Dokumentacion: Regjistri i inspektimeve mbahet në zyrën e sigurisë së kompanisë dhe kontrollohet gjatë auditimeve të brendshme;
- Masë parandaluese: Pas një zhurme jonormale, pajisja ndalet dhe nuk rrvihet në përdorim deri pas kontrollit të jashtëzakonshëm.



Disa pajisje të punës përfshijnë rreziqe të veçanta, e kur kemi të bëjmë me sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve, atëherë punëdhënësi duhet të ndërmarrë masat e nevojshme për të siguruar që pajisja e punës të përdoret vetëm nga ata persona që janë të detyruar për ta përdorur. Në rast të instalimeve, ç'instalimeve, ndryshimeve, përshtatjeve, mirëmbajtjes, shërbimeve dhe riparimeve të pajisjes së përdorur, ata të punësuar që ndërmarrin ndonjë hap nga të lartpërmendurat, duhet të jenë të kualifikuar dhe të ngarkuar veçanërisht për këtë punë.

**Kriteret themelore të sigurisë** që duhet të plotësojnë të gjitha pajisjet e punës (qofshin ato të reja apo ekzistuese), për të siguruar përdorim të sigurt dhe të besueshëm nga punonjësit, përfshijnë:

- 1. Stabilitetin dhe qëndrueshmërinë strukturore** - Pajisjet duhet të jenë të qëndrueshme gjatë funksionimit, pa rrezik të lëvizjes ose rrëzimit të papritur që mund të cenojë sigurinë e përdoruesit apo ambientit.
- 2. Mbrojtja ndaj pjesëve të rrezikshme** - Të gjitha pjesët lëvizëse që mund të shkaktojnë lëndime, duhet të jenë të mbuluara ose të pajisura me mbrojtëse të posaçme që ndalojnë kontaktin e drejtpërdrejtë.
- 3. Sisteme të besueshme kontrolli** - Pajisjet duhet të kenë pajisje kontrolli (si: butona, levë, panel komandimi) që janë të lehta për t'u përdorur, të vendosura në pozita të qasshme dhe që mundësojnë ndërprerjen e menjëhershme të funksionit në rast nevoje.



4. **Ndërprerje emergjente** - Duhet të sigurohet një mekanizëm i ndaljes urgjente, i cili është lehtësisht i dallueshëm dhe i përdorshëm nga punonjësi, duke ndihmuar në parandalimin e aksidenteve fatale.
5. **Mbrojtja nga rreziqet elektrike, termike dhe kimike** - Pajisjet nuk duhet të shkaktojnë rrezik nga nxehtësia e tepërt, rryma elektrike apo kontakti me substanca të rrezikshme gjatë përdorimit normal ose gjatë avarive.
6. **Lehtësia e mirëmbajtjes dhe pastrimit** - Pajisjet duhet të jenë të dizajnuara në mënyrë që të pastrohen dhe mirëmbahen pa krijuar rrezik për personin që kryen këto operacione.

Gjithashtu janë disa kërkesa të posaçme për pajisje të veçanta, të cilat paraqesin rrezik më të lartë për shkak të natyrës së tyre funksionale ose kushteve në të cilat operojnë.

### **Pajisjet e përfshira dhe kërkesat specifike:**

#### **1. Pajisjet lëvizëse brenda vendit të punës (si makina transportuese, pirunngritës, automjete të brendshme), duhet të:**

- jenë të pajisura me sistem frenimi dhe ndalimi efikas;
- kenë sinjalizim akustik dhe vizual për parandalimin e përplasjes ose goditjes;
- operohen vetëm nga persona të trajnuar dhe të autorizuar.

#### **2. Pajisjet ngritëse dhe transportuese (vinça, liftëra industriale, etj.), duhet të:**

- jenë të qëndrueshme dhe të pajisura me pajisje sigurie për peshën maksimale të lejuar;
- përdoren në mënyrë të kontrolluar, sipas udhëzimeve të prodhuesit dhe praktikave të mira të sigurisë;
- inspektohen rregullisht dhe të jenë pjesë e një regjistri mirëmbajtjeje.

#### **3. Pajisjet që përdoren në lartësi, duhet të:**

- kenë sisteme të mbrojtjes kundër rënies (si mbrojtëse anësore, rripa sigurie, platforma të sigurta);
- jenë antirreshqitëse dhe të dimensionuara sipërfaqet ku punohet, në mënyrë të përshtatshme për lëvizje të sigurt;
- jetë e kufizuar dhe e kontrolluar qasja në këto pajisje.

## **ERGONOMIA DHE SHËNDETI NË PUNË**

Punëdhënësi për zbatimin e kërkesave minimale të sigurisë dhe shëndetit në punë, duhet të marrë përsipër të gjithë organizimin e vendit të punës dhe pozicionin e të punësuarëve, gjatë përdorimit të pajisjeve të punës, si dhe parimet ergonomike. Punëdhënësi duhet të ketë qëllim të sigurojë që pajisjet e punës dhe mënyra e përdorimit të tyre, të jenë të përshtatshme për trupin e punëtorëve dhe të mos shkaktojnë lodhje të panevojshme, lëndime muskulare, stres fizik apo shqetësime të tjera shëndetësore.




Detyrimet kryesore të punëdhënësit për ergonominë:

1. Pajisjet duhet të jenë të dizajnuara për t'iu përshtatur dimensioneve trupore të përdoruesit;
2. Lartësia, pozicioni dhe forca e kërkuar për përdorim nuk duhet të shkaktojnë tendosje fizike ose sjellje të detyruara të trupit.
3. Reduktimi i lodhjes dhe stresit fizik: Duhet të shmangen veprimet e përsëritura dhe qëndrimet për periudha të gjata dhe duhet të sigurohen pushime të rregullta, gjatë përdorimit të pajisjeve që kërkojnë përqendrim ose sforcim të madh fizik.
4. Vendosja e pajisjeve në pozita të arritshme: Komandat dhe kontrollat e pajisjes duhet të jenë lehtësisht të aksesueshme pa nevojë për lëvizje të tepërta ose joergonomike; Pajisjet që përdoren rregullisht duhet të jenë të pozicionuara në zonën më të rehatshme për përdoruesin.
5. Ndriçimi, zhurma dhe ambienti i punës: Vendndodhja e pajisjeve duhet të garantojë ndriçim të mirë, minimizim të ekspozimit ndaj zhurmës dhe mikroklimë të përshtatshme (temperaturë, lagështi, ventilim).

Shembuj praktikë të ergonomisë në vendin e punës:

### 1. Puna në kompjuter (zyrë):

- Lartësia e monitorit duhet të jetë në nivelin e syve;
- Duart duhet të qëndrojnë në vijë të drejtë me parakrahët mbi tastierë;
- Karrigia duhet të jetë ergonomike dhe me mbështetëse për shpinë;
- Pushime të shkurtra çdo 30-45 minuta për të shmangur lodhjen vizuale dhe muskulare.



### 2. Punë fizike në prodhim:

- Punonjësi nuk duhet të ngrëjë peshë të madhe mbi 25 kg pa ndihmë;
- Pajisjet e ngritjes automatike ose paletueset duhet të jenë në dispozicion;
- Sipërfaqet e punës duhet të jenë në lartësi të përshtatshme për të shmangur përkuljen e trupit.

## INFORMIMI, TRAJNIMI DHE KONSULTIMI I TË PUNËSUARËVE

**Informimi i të punësuarëve dhe të vetëpunësuarëve** në përdorimin e pajisjeve të punës, duhet të bëhet nga punëmarrësi, madje nëse është e nevojshme kjo duhet të bëhet edhe me shkrim.



Informacionet që bëhen me shkrim duhet të përmbajnë këto kushte për përdorimin e sigurtë të pajisjeve të punës;

1. Situatat joformale të parashikueshme;
2. Kërkesat e sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjes së punës;
3. Konkluzionet që rrjedhin nga përvoja e përfituar gjatë shfrytëzimit të pajisjeve të punës.



Punëmarrësi duhet që informacionet t'i ofrojë të shtjelluara mirë, të kuptueshme për të punësuarit dhe të interesuarit. Të informojë punëmarrësit për mënyrën e duhur të përdorimit të çdo pajisjeje pune, të shpjegojë rreziqet që lidhen me pajisjen dhe masat mbrojtëse që duhen marrë, të sigurojë që udhëzimet të jenë të shkruara, të qarta, dhe të qasshme, të vendosë udhëzime vizuale ose tabela afër pajisjeve të rrezikshme.

**Trajnimi i të punësuarëve** është obligim i punëdhënësit, i cili duhet të garantojë që çdo punëmarrës që përdor pajisje pune, është i trajnuar dhe i aftësuar për përdorim të sigurt dhe efikas. Punëdhënësi ofron trajnime për të punësuarit, duke përfshirë trajnimet për çdo risk të mundshëm, nëpërmjet demonstrimeve lidhur me pajisjet e përdorura të punës. Trajnimet duhet të bëhen kur punëmarrësi fillon punë për herë të parë, kur kemi instalim të ndonjë pajisjeje të re, kur ka ndryshime në mënyrën e përdorimit të pajisjes, pas ndonjë incidenti/aksidenti ose rreziku të raportuar, gjithashtu edhe për rifreskim njohurish. Përfitimet nga trajnimi i të punësuarëve është tejet profitabil pasi që përmes trajnimeve të mbajtura të punësuarit, përfitojnë njohuri të veçanta dhe të përgjithshme në aftësimin profesional për vendin e tyre të punës.

### **Përgjegjësitë e të punësuarëve**

Të përdorin pajisjet vetëm sipas udhëzimeve të dhëna nga punëdhënësi dhe në përputhje me trajnimet e marra;

Të raportojnë menjëherë çdo defekt ose situatë të rrezikshme te përgjegjësi i sigurisë;

Të përdorin mjetet personale mbrojtëse në mënyrë të duhur;

Të marrin pjesë në trajnimet dhe përditësimet që lidhen me pajisjet e punës.

**Konsultimi dhe pjesëmarrja e të punësuarëve** është e drejtë e çdo punëmarrësi e përcaktuar në nenin 19 të Ligjit Nr. 04/L-161 për Siguri dhe Shëndet në Punë, i cili thotë:

“1. Punëdhënësi duhet të konsultohet me të punësuarit dhe përfaqësuesit e tyre duke i'u mundësuar atyre të marrin pjesë në diskutime lidhur me çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë, që përfshijnë: 1.1. masat që duhen ndërmarrë, të cilat mund të kenë ndikim të konsiderueshëm në rritjen e nivelit të sigurisë dhe shëndetit në punë; 1.2. informacionin për vlerësimin e rreziqeve, masat mbrojtëse dhe parandaluese, regjistrin dhe raportet e aksidenteve në punë, si dhe raportet nga inspektorati; 1.3. listën e personave ose të shërbimeve të jashtme që kontraktohen për të kryer shërbime sipas nenit 9 të këtij Ligji; 1.4. planin dhe organizimin e trajnimeve të punëtorëve nga siguria dhe shëndeti në punë.



2. Përfaqësuesit e të punësuarve dhe anëtarët e Këshillit për Siguri dhe Shëndet në Punë, kanë të drejtë të kërkojnë nga punëdhënësi që të ndërmarrë masa adekuate dhe të dorëzojnë propozime tek ai, me qëllim të zvogëlimit të rreziqeve për të punësuarit ose të largojë burimet e rrezikut.

3. Të punësuarit ose përfaqësuesit e tyre kanë të drejtë ankese në përputhje me ligjet, tek inspektori i punës, nëse ata konsiderojnë që masat e ndërmarra nga punëdhënësi nuk janë adekuate dhe të mjaftueshme për sigurinë dhe shëndetin në punë.

4. Përfaqësuesve të të punësuarëve duhet t'u jepet rasti që të paraqesin vërejtjet e tyre tek inspektori i punës, për mangësitë që kanë ndikim në sigurinë dhe shëndetin në punë.”<sup>1</sup>

### **Çfarë nënkupton ky nen në praktikë:**

- Punëdhënësi nuk duhet të marrë vendime të njëanshme për masat e sigurisë;
- Punonjësit kanë të drejtë të informohen dhe të japin mendim për çdo ndryshim që ndikon në sigurinë apo shëndetin e tyre;
- Duhet të ekzistojë një **strukturë e përhershme e përfaqësimit** / përfaqësuesi i punëtorëve për siguri.

**Shembull praktik:** Në një fabrikë përpunimi, përpara instalimit të një linje të re makinerish, punëdhënësi organizon një **konsultim me përfaqësuesit e punëtorëve**, për të shqyrtuar:

- Rreziqet e mundshme të teknologjisë së re;
- Nevojat për trajnime shtesë;
- Vendosijen e pajisjeve mbrojtëse;
- Ndikimin në rrjedhën e punës.

## **LEGJISLACIONI LIDHUR ME KËRKESAT MINIMALE TË SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PËRDORIMIN E PAJISJEVE TË PUNËS NË VENDIN E PUNËS**

Legjislacioni i mëposhtëm zbatohet dhe duhet të merret parasysh kur planifikoni çdo lloj aktiviteti të punës me përdorimin e pajisjeve të punës në vendin e punës:

**Ligji Nr.04/L-161/2013 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë;**

**Rregullore (MPMS) Nr. 05/2014 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në përdorimin e pajisjeve të punës në vendin e punës;**

---

<sup>1</sup> Ligji nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, maj 2013, f. 10.



**Rregullore (MPMS) Nr. 02/2020 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 05/2014 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në përdorimin e pajisjeve të punës në vendin e punës.**

## AUDITIMET

Punëdhënësi duhet të ketë auditime të brendshme/vetinspektime sipas listës së sugjeruar në Shtojcë. Kjo do t'u mundësojë atyre që të menaxhojnë në mënyrë efektive sigurinë dhe shëndetin dhe gjithashtu t'i përgatisë ata për çdo auditim të jashtëm siç janë Rregullatori (Inspektorati i Punës) dhe Certifikimi, nëse ka të tilla.

## VËREJTJET PËRFUNDIMTARE

**Mbani mend:** Ndjekja e udhëzimeve të mësipërme do të zvogëlojë rreziqet në përdorimin e pajisjeve të punës në vendin e punës.

## SHTOJCA 1: SHEMBUJ TË FAKTORËVE TË RREZIKUT PËR KËRKESAT MINIMALE TË SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PËRDORIMIN E PAJISJEVE TË PUNËS NË VENDIN E PUNËS

Si pjesë e procesit të vlerësimit të kërkesave minimale të sigurisë dhe shëndetit, në përdorimin e pajisjeve të punës në vendin e punës, do të jetë e nevojshme të identifikohen faktorët e rrezikut që janë të rëndësishëm për një detyrë të veçantë. Kjo listë kontrolli është një rikujtim (aide-memoire) i dobishëm, për të identifikuar faktorët e rrezikut si pjesë e procesit të vlerësimit të riskut. Informacioni i mbledhur më pas mund të përdoret për të identifikuar se çfarë përmirësimesh mund të vendosen për të mënjanuar ose zvogëluar rreziqet në vendin e punës.

FAKTORËT E RREZIKUT	PO	JO	KOMENT
A janë pajisjet e punës të përshtatshme në vendin e punës dhe a përdoren në mënyrë të sigurtë nga punëmarrësit?			
A janë pajisjet e punës të projektuara për përdorim gjatë natës apo në vende të errëta, të pajisura me ndriçim të përshtatshëm për kryerjen e punës në mënyrë të sigurt?			
A përdoren pajisjet e punës me risqe të veçanta, vetëm nga punëmarrësit që janë përcaktuar për ato detyra?			
A garantojnë kushte të sigurta për punë, pajisjet e instaluar të punës?			



A është marrë në konsideratë që organizimi i vendit të punës dhe pozicioni ku operatorët manipulojnë janë ergonomik?			
A janë të dukshme dhe funksionale mjetet e komandimit?			
A posedon fushëpamje të qartë, operatori i makinerisë nga pozicioni i komandimit?			
A posedojnë pajisjet e punës sistemin e komandimit për ndalim të tyre të plotë?			
A garantojnë siguri mjetet e lëvizshme të punës me puntorë në të, përfshirë kontaktin e këtyre personave apo shtypjen e tyre me rrotat apo vet mjetin?			
A janë projektuar në atë mënyrë që të kufizojë kushtet e përdorimit, mjetet e lëvizshme me puntorë në të, aty ku risku i batimit / rrokullisjes është i pranishëm?			
A janë siguruar nga risku i përmbysjes, automjetet që transportojnë një ose më shumë të punësuar?			
A janë marrë masat e nevojshme të sigurisë, për pajisjet vetëlëvizëse të cilat mund të sjellin risqe për punëtorët?			
A merren masat e nevojshme të sigurisë për pajisjet të cilat kanë rrezik të ndezjes së zjarrit?			
A janë të mjaftueshme masat e sigurisë për përdorimin e sigurtë të pajisjeve me telekomandë?			
A janë të sigurta dhe të qëndrueshme, pajisjet ngritëse të instaluar në mënyrë të përhershme/ permanente?			
A merren masat e nevojshme të sigurisë për të shmangur apo zvogëluar riskun e goditjes nga ngarkesat gjatë ngritjes me pajisjet ngritëse të instaluar në mënyrë të përhershme?			
A i është siguruar të punësuarve dokumentacioni përcjellës i pajisjeve të punës në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës, si dhe në gjuhë të tjera të kuptueshme lidhur me përdorimin, funksionimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e tyre të sigurtë?			
A garantohet siguri për ngritjen e ngarkesave të padrejtuara në rast të ndërprerjes së energjisë?			
A është bërë një vlerësim risku për punën në lartësi me platforma të varura në litarë?			
A bëhet vetëm nga personat kompetentë, montimi i pajisjeve ngritëse të instaluar në mënyrë të përhershme / permanente?			



A kanë punëmarrësit njohuri për rreziqet e zjarrit?			
A është bërë një vlerësim risku për punën në lartësi me platforma të varura në litarë?			